



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr 407 prot

Vlorë më 05/03 /2020

VENDIM

Nr. 1 datë 26/02 /2020

**“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAM BUXHETIN
AFAT - MESËM 2021-2023”**

Këshillit të Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga *Grupi i Menaxhimit Strategjik*, për hartimin e tavanëve përgatitore për PBA 2020-2022, të Këshillit të Qarkut Vlorë, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore,, neni 41, pika1, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68 dt.2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore, neni 33,, pika 1.
- Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, me ndryshimet e bëra,,.
- Ligji nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019 ,, neni 16.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.9 datë 20/03/2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit,,.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.23 datë 30/07/2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesë të njëjësive të vetqeverisjes vendore,,.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.7, dt. 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023,,.

VENDOSI:

1-Të miratojë tavanet përgatitore për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 :

- Planin e transfertës së pakushtëzuar
- Planin e transfertës së kushtëzuar
- Planin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut

2-Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria Ekonomike & Shërbimeve.

3-Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Këshill.

4- Planet e tavanëve përgatitore sipas tabelës bashkëlidhur.

2

Grupi i Menaxhimit Strategjik